

Edukatë Qytetare

Klasa XI

HYRJA

Në drejtimin Gjinnazi shoqëror, edukata qytetare mësohet edhe në klasën XI me nga 2 orë në javë.

Në klasën XI edukata qytetare ka vetëm një kategori LIDHJA GLOBALE që ndahet në tri nënkategori:

- **Integrimet,**
- **organizatat ndërkombëtare,**
- **problemet globale dhe mjedisi.**

Programi i edukatës qytetare mbështetet në kërkesat aktuale të shoqërisë kosovare për përgatitjen e qytetarit aktiv të së sotmes dhe të së ardhmes, qytetar të një bote e gjithnjë më të ndërvarur.

Integrimet (ndikimet dhe kushtëzimet reciproke) janë tashmë, jo vetëm trende, por realitete dhe atë në të gjitha fushat, si integrimet politike, ekonomike, ushtarake, kulturore, arsimore, sportive etj. sepse edhe problemet janë globale siç është zhvillimi, siguria, shëndeti, ndotja e mjedisit.

E ardhmja, zhvillimi global i shoqërisë po bëhet preokupim gjithnjë më i madh i njerëzve, por edhe shteteve në vendimmarrje për përcaktimin e politikave zhvillimore të tyre.

Në këtë kontekst edhe zgjidhjen e çështjeve tona kombëtare (veçmas çështjes së Kosovës) si dhe problemeve rajonale e më gjerë, duhet parë edhe nga këndi dhe trendi i zhvillimeve dhe integritimeve globale.

Edukata qytetare synon të krijojë te nxënësi ndjenjën e të qenit, jo vetëm qytetar i Kosovës, por edhe qytetar global, qytetar i botës, me fjalë të tjera të aftësohet t'i vështrojë problemet, zhvillimet dhe ndërlidhjet edhe nga aspekti global.

QËLLIMET

Lënda e edukatës qytetare ka për qëllim:

- *të vetëdijësojë nxënësit për vartësinë dhe kushtëzimin gjithnjë më të madh të botës në të cilën jetojmë;*
- *të jenë në gjendje nxënësit të gjykojnë për vendimet personale, kombëtare dhe globale, për bashkëpunimet dhe pasojat, duke përfshirë çështjet si: paqja, të drejtat e njeriut, tregtia dhe ekologjia globale;*
- *të mundësojë përfshirjen e nxënësve në trajtimin e çështjeve të ndryshme globale;*
- *të zhvillojë ndjenjën e tolerancës, të respektimit të mendimeve të të tjerëve dhe të zgjidhjes paqësore të konflikteve në komunitet dhe më gjerë;*
- *të ndërgjegjësojë nxënësit se e ardhmja e Kosovës varet nga veprimi i sotëm qytetar i qytetarëve të saj.*

OBJEKTIVAT

Në bazë të qëllimeve të programit të klasës XI, nxënësi duhet të arrijë këto objektiva:

Të njohë

- ✚ konceptet e globalizmit, integrimit, ndotjes së mjedisit;
- ✚ stilet e ndryshme të jetës dhe sjelljeve të njerëzve në vendet e ndryshme të botës;
- ✚ faktorët social që ndikojnë në probleme globale;
- ✚ proceset integruese, rajonale, evropiane dhe botërore.

Të kuptojë

- ✚ ndërvartësinë globale në fushat e ndryshme jetësore: kujdesi mjekësor, zhvillimi ekonomik, cilësia e ambientit dhe liritë e të drejtat e njeriut;
- ✚ funksionin e organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare;
- ✚ lidhjet dhe këndvështrimet e njerëzve me faktorë të tillë si mosha, besimi, kultura, konteksti gjeografik, gjuha, kombi, raca, e të tjera.

Të analizojë

- ✚ faktorët që lehtësojnë dhe vështirësojnë zhvillimin e proceseve globalizuese;
- ✚ ndikimin e teknologjisë në komunitetin global;
- ✚ aspekte të ndryshme të globalizimit të jetës sociale në Kosovë;
- ✚ pozitën e Kosovës në raport me organizmat ndërkombëtarë;
- ✚ pasojat e ndotjes së mjedisit në përmasa lokale dhe globale.

Të vlerësojë

- ✚ se si kultura, gjuha, edukimi, besimet etj. lehtësojnë ose vështirësojnë zhvillimin e proceseve globalizuese;

- ✚ probleme të veçanta që lidhen me marrëdhëniet ndërmjet sovranitetit kombëtar dhe proceseve globale;
- ✚ rolin e qeverive dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare dhe vendore në zgjidhjen e problemeve globale.

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- ✚ në respektimin e stileve të ndryshme të jetës;
- ✚ të jetë i hapur e tolerant dhe të kundërshtojë çdo formë diskriminimi gjinor, etnik, fetar dhe racor;
- ✚ të përgjegjësive për përkujdesjen e mjedisit.

**STRUKTURA E PROGRAMIT
(2 orë në javë, 70 orë në vit)**

Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i orëve
LIDHJET GLOBALE	Integrimet	30
	Organizatave ndërkombëtare	25
	Problemet globale dhe mjedisi	15

I. LIDHJET GLOBALE

I.1 INTEGRIMET

Përmbajtja programore

Nxënësit të përvetësojnë përmbajtjen dhe funksionin e koncepteve si: globalizimi, politikat globale, politikat integruese.

Kosova dhe marrëdhëniet e saj politike në rajonin e Ballkanit, në Evropë dhe në botë.

Bashkëpunimi ekonomik i Kosovës me vendet rajonale dhe më gjerë.

Ndikimi i organizatave, kompanive vendore, rajonale dhe më gjerë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Edukimi ndërkulturor (kultura dhe modelet e ndryshme ndërkulturore).

Roli i mediave në politikat integruese.
Këmbimet në fushën e arsimit dhe kulturës ndërmjet Kosovës, vendeve të rajonit dhe më gjerë.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- shpjegon ç'është globalizimi, si reflektohet ai në botën bashkëkohore dhe në jetën e përditshme të njerëzve;
- përshkruan si realizohen politikat integruese, kushtet dhe standardet për integrim;
- përshkruan rëndësinë që ka për zhvillimin ekonomik bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, organizatat rajonale, kompanitë nacionale dhe multinacionale;
- shpjegon kahet dhe rrugët e integritit të Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare;
- analizon marrëdhëniet politike dhe ekonomike të Kosovës në rajon dhe më gjerë,
- vlerëson rëndësinë e këmbimeve kulturore, arsimore dhe shkencore të Kosovës me vendet rajonale dhe më gjerë.

I.2. ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Përmbajtja programore

Nxënësi duhet të mësojë: konceptet, funksionet, përgjegjësitë dhe strukturën e organizatave kryesore ndërkombëtare, si:

- OKB - Organet kryesore, komitetet dhe institucionet më të rëndësishme të saj;
- Misioni ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK-u;
- Organet më të rëndësishme të Bashkësisë Evropiane: Këshilli i Evropës; komitetet, institucionet e komiteteve evropiane, organet ndihmëse dhe funksionet e tyre;
- Misionet paqëruajtëse në botë. Misioni paqëruajtës në Kosovë, KFOR- i;
- Organizatat ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare, si UNESCO, UNICEF, IOM, UNDP, UNHCR, Kryqi i kuq e organizata të tjera të rëndësishme;
- Kosova në raport me organizatat ndërkombëtare.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- dallon organizatat qeveritare nga ato joqeveritare;
- identifikon organet më të rëndësishme të organizatave qeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare dhe vendore;
- dallon rolin dhe funksionin e organeve të OKB prej institucioneve të OKB;
- përshkruan rolin dhe kompetencat e OKB në avancimin e të drejtave të njeriut me shembuj konkret] në shtete të ndryshme të botës;

- përshkruan komitetet më të rëndësishme globale dhe evropiane: Këshillin e Evropës, institucionet e komiteteve dhe organet ndihmëse, si dhe organizatat ndërkombëtare joqeveritare, si UNESCO, UNICEF, IOM, UNDP, UNHCR, Kryqi i kuq;
- analizon kontributin e organizatave qeveritare dhe joqeveritare në Kosovë.

I. 3. PROBLEMET GLOBALE DHE MJEDISI

Përmbajtja programore

Nxënësi të mësojë:

Format e shfaqjes së problemeve në komunitetin ku jetonë dhe në nivel global (papunësia /varfëria/, emigracioni, natyralizimi, narkomania, SIDA, kriminaliteti, burimet e energjisë, biodiversiteti, ndotja e mjedisit);

Konceptet e ndotjes së mjedisit në nivel global, *ndryshimet klimatike- vrimat e ozonit, efektet e serr]s, shirat e tharta, ngrohja globale, baraspesha ekologjike, dhe rreziku b]rthamor.*

Rolin e shteteve, organizatave qeveritare dhe joqeveritare që veprojnë në botë, rajon dhe në Kosovë për evitimin e rrezikut të ndotjes së mjedisit dhe problemeve t] tjera globale.

Siguria ndërkombëtare dhe mjedisi.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- identifikon problemet globale që shqetësojnë shoqërinë njerëzore si papunësia (varfëria), pasiguria, shëndeti, emigracioni, burimet e energjisë dhe ndotja e mjedisit;
- identifikon shkatarrët e ndotjes së mjedisit në nivel lokal dhe global;
- analizon pasojat e ndotjes së mjedisit në përmasa globale;
- identifikon organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare dhe vendore që merren me problemet globale dhe çështje të mjedisit;
- vlerëson rolin e organizatave qeveritare dhe joqeveritare që merren me çështje të mjedisit në Kosovë.

II. QASJA LËNDORE DHE NDËRLËNDORE

Edukata qytetare trajton probleme nga më të ndryshmet për qytetarin dhe qytetarinë. Përmbajtja e programit të edukatës qytetare për klasën XI- të që përmblihet në kategorinë LIDHJET GLOBALE është gërshetim përmbajtjesh programore nga

shumë disiplina të shkencave shoqërore, humane, natyrore dhe të artit. Kjo kategori është shembull tipik i ndërvartësisë dhe lidhjeve koherente horizontale dhe vertikale të përmbajtjeve programore të sferave të ndryshme të jetës dhe të dijes. Globalizmi është proces kompleks, gjithëpërfshirës dhe për t'u kuptuar mirë kërkon trajtim shumëdimensional.

Procesi i globalizmit i prek të gjitha segmentet e jetës, prej sferave shoqërore, pra politikës (politikave integruese) e deri te problemet e ndotjes së mjedisit. Siç shihet nga përmbajtja programore e edukatës qytetare kl-XI-të ekzistojnë lidhje të ngushta lëndore dhe ndërlëndore ndërmjet kësaj përmbajtjeje dhe përmbajtjeve programore të pothuaj gjitha lëndëve mësimore që mësohen në klasën XI-të. Megjithatë, raporte më të përafërta korrelative ka me;

- sociologjinë, drejtësinë (marrëdhëniet ndërkombëtare);
- ekonominë - prodhime të ndryshme industriale, multikompanitë, nafta, industrializimi, tregtia, monedha e përbashkët,
- gjeografinë (demografinë);
- historinë – lindja e organizatave ndërkombëtare dhe funksioni i tyre në të kaluarën;
- biologjinë (ekologjinë e mjedisit), biodiversiteti trajtohet edhe në biologji – përmbajtjet që u përkasin specieve të bimëve e të kafshëve;
- fizikën - ndikimin e radioaktivitetit në ndotjen e mjedisit;
- kimin – gazrat serrë janë dioksidin e karbonit, gazi metan, klorofluorkarbonet, acidi nitrik, mbeturinat helmuese bërthamore e të tjera;
- informatikën dhe teknologjinë;
- gjuhët dhe artet si mjete komunikimi masiv dhe global reflektojnë drejtpërdrejt edhe në përmbajtjen e lëndës së edukatës qytetare për klasën XI-të.

Mbetet detyrë e arsimtarit që gjatë planifikimit dhe zhvillimit të përmbajtjeve programore të jetë në kontakt dhe hap të vazhdueshëm me arsimtarët e lëndëve të tjera në mënyrë që t'i harmonizojnë veprimet dhe të njëjtës përmbajtje programore t'i qasen njëkohësisht nga kënde të ndryshme por komplementare që e begatojnë dhe plotësojnë tërësinë programore siç është globalizmi.

III. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Programi i edukatës qytetare mësuesit i ofron mundësi kreative në organizimin-planifikimin dhe në realizimin e qëllimeve, objektivave dhe arrijtjen e rezultateve të pritshme. Renditja e nënkategorive (renditja e përmbajtjes mësimore brenda nënkategorisë) apo caktimi i fondit të orëve për realizimin e tyre mund të ndryshohet nga **Struktura e programit**, por gjithnjë duke pasur parasysh rezultatet e pritshme. Një njësi mësimore mund të punohet për një orë mësimore, por nëse mësimdhënësi vlerëson së ajo njësi është e shkurtër, apo nxënësit, nuk kanë njohuri të mjaftueshme paraprake për ato përmbajtje programore, ai mund ta zgjerojë në dy njësi mësimore. Po ashtu, mund të kombinohen njësitë mësimore të nënkategorive të ndryshme në një njësi mësimore të vetme.

Me qëllim realizimi të suksesshëm të programit të edukatës qytetare të klasës XI mund të përdoren *metodologjitë: të nxënës ndërvprues (interaktiv) që nxit të mësuarit mes nxënësve.; të nxënës duke zgjidhur probleme; mësimdhënia me nxënës në qendër; të nxënës me projekte dhe sidomos të nxënës përmes zbulimit janë mjaft efektive dhe të preferuara për mësimdhënës të edukatës qytetare në nivelin e tretë.*

Metodat e tilla si: zhvillimi i mësimit nga vetë nxënësit; diskutimi; loja në role; zgjojet e bletëve; simulimi; aktivitetet që synojnë vendosjen e prioriteteve, marrjen e vendimeve, zgjidhjen e problemeve të mjedisit si dhe bisedimet rreth problemeve siç janë narkomania, SIDA, kriminaliteti, etj. mundësojnë aktivizimin praktik të nxënësve në zgjidhjen e çështjeve imediate që shqetësojnë grupin, komunitetin apo mbarë shoqërinë.

Mësimdhënësit kanë mundësi të zbatojnë edhe metodën Brainstorming (stuhi mendimesh) e cila në praktikë është treguar mjaft e suksesshme.

Mësimdhënësi mund të aplikojë shumë veprimtari praktike (ese, fletë pune etj.).

III. VLERËSIMI

Përmes vlerësimit konfirmohet shkalla e arritjes së kërkesave të rezultateve të pritura të parapara në planin dhe në programin e klasës XI, duke filluar nga shkalla më e ulët e kërkesave si identifikimi, përshkrimi e deri te shkalla më e lartë si analiza, sinteza, konstruktmi, vlerësim i dukurive

Vlerësimi sjell informata për përparim apo për vështirësitë në përparim të nxënësit si rezultat i përshtatshmërisë së planeve dhe programeve dhe metodologjisë efektive apo joefektive të mësimdhënies.

Përparimi i nxënësit në përputhje me rezultatet e pritshme duhet të vlerësohet nga kënde të ndryshme. Ky vlerësim gjithëpërfshirës mund të bëhet përmes vëzhgimit, detyrave, testeve, dosjeve, projekteve, por duke mos përjashtuar edhe mundësitë e tjera që parasheh mësuesi.

Vëzhgimi mund të përqendrohet në:

- ✚ Aftësitë e nxënësit për punë në grupe (*Si bashkëpunon? Përgjegjësitë për detyrën e ndarë brenda grupit / sa është tolerant në marrjen e vendimeve – si arrihet konsensusi? Aftësitë në udhëheqje*), për punë të pavarur.
- ✚ Mënyrat e gjetjes së informacioneve për përmbajtjen e caktuar (*Nga janë marrë informacionet? Cilat burime janë shfrytëzuar? Si burim është shfrytëzuar vetëm libri apo nxënësi ka shfrytëzuar edhe burime të tjera të mundshme, p.sh personalitete, organizata, broshura, gazeta, ...?*).
- ✚ Qasjet e nxënësit ndaj librit dhe burimeve të tjera të shkruara: *vetëm i interpreton të dhënat; i krahason ato; ka qëndrim kritik ndaj librit dhe burimeve të tjera të shkruara; i shfrytëzon të dhënat në libër si udhërrëfyes për shfrytëzim të burimeve të tjera;*
- ✚ Cilësinë e prezantimit të punës, informatave, rezultateve .
- ✚ Prirjet e nxënësit, interesat, pjesëmarrjen në aktivite të ndryshme.
- ✚

Detyrat e dhëna nga mësuesi në kontekst të të nxënës mundësojnë vlerësimin e proceseve dhe rezultateve të tyre . Mësuesi mund të vlerësojë proceset në të cilat nxënësit janë të përfshirë dhe të mbledhë informata çfarë kanë mësuar ata. Dhënia e detyrave që

nxënësin vënë në situatë ku ai në grup duhet t'i mbrojë vendimet dhe opinionet e grupit, e ndihmon mësuesin të vlerësojë si nxënësi punon në grup, si arrin të konsensusi me të tjerët dhe se përfundimet që japin nxënësit janë të qëndrueshme apo jo të qëndrueshme.

Krahas vëzhgimit është me rëndësi që në periudha të caktuara me anë të testit të verifikohet shkalla e arritshmërisë për përmbajtje të caktuara. Kjo teknikë vlerësimi mund të zbatohet në fund të orës mësimore (për verifikim të arritjes së objektivave të orës mësimore), në fund të kapitujve apo në fillim të kapitujve (mësuesi ta ketë të qartë çfarë njohuri paraprake kanë nxënësit në mënyrë që të planifikojë punën e mëtutjeshme), pas periudhës tremujore, gjysmëvjetorit apo në fund të vitit mësimor nëvartësi nga ajo që dëshirohet të matet.

Përmes dosjes mund të mbahet evidencë e gjerë e të arriturave të nxënësit. Punimet e punuara nga nxënësi, si: *pyetësorët e shfrytëzuar për intervista, projekte të punës, aktivitetete të shkruara, faqe të gazetave / revistave, përgjigjet në testet e caktuara, vizatime apo materiale të ndryshme*, mundësojnë përcjelljen e të arriturave të nxënësit dhe transparencë për nxënësin dhe prindërit. Ky vlerësim fuqizon lidhjen e mësuesit me prindërit dhe me nxënësit dhe rrit rolin e nxënësit në të nxënë.

Vlerësimi i nxënësit nga mësuesi, vetëvlerësimi si dhe vlerësimi nga nxënësit e tjerë bëhet edhe gjatë punës së projekteve. Ndarja e punëve nga mësuesi apo nga vetë nxënësit p.sh. për njohjen e kulturave të disa popujve kërkon ndarje të detyrave në bazë të aftësive të nxënësve për mbledhjen e informatave, krahasimin dhe prezantimin e tyre, si dhe aftësive të tyre për punë me të tjerët.

IV. BURIMRMET DHE LITERATURA

Për metodologji të mësimdhënies

1. Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003
2. Bardhyl Musai, Psikologjia e edukimit, Tiranë, 2003
3. Erlehta Mato & Pranvera Kamani, Në kërkim të njohjes, Tiranë, 2000
4. Fondacioni: Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, KONFLIKTI DHE KOMUNIKIMI, Tiranë, 1997
5. Grup autorësh, Edukimi ndërkulturor dhe i të drejtave të njeriut në shkollë, Tiranë, 2003
6. Grup autorësh, Mesazhe nga klasa – Ide dhe modele për mësimdhënie me nxënësin në qendër, (KEDP) Prishtinë, 2003
7. Grup autorësh, Qeverisja dhe udhëheqja në arsim, KEC, Prishtinë, 2003
8. Grup autorësh, Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit, Tiranë, 1998

Për përmbajtje

1. albania.rec.org
2. Faton Abdullahu, Dimensionet e identitetit qytetëruar, kultura, feja, politika, Prishtinë, 1998
3. Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KCSF), **Lista e OJQ-ve të Kosovës**, Prishtinë, 2001

4. Grup autorësh, E drejta evropiane e të drejtave të njeriut, Prishtinë, 2002
5. Grup autorësh, Hyrje në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Prishtinë, 2001
6. Instituti i Studimeve Pedagogjike, Arsimi nëpër botë, Tiranë, 1997
7. Joshua S. Goldstein, Marrëdhëniet ndërkombëtare, Tiranë, 2003
8. Karl Dojç, Analiza e marrëdhënieve ndërkombëtare, Tiranë, 1994
9. Kultura e demokracisë sfidë për shkollat, Tiranë, 1995
10. Philip Thody, Hyrje historike e unionit evropian, Prishtinë, 2002
11. Skënder Sylaj, Mbrojtja dhe shpëtimi nga fatkeqësitë elementare natyrore, Prishtinë, 2001
12. www.dadalos.org
13. www.moe.gov.al